

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Isa Kelmendi dhe Gëzim LLulluni, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.M., M.M., L.M. dhe M.M.2, të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson O.Z., avokat nga Prizreni, kundër të paditurit Xh.H., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson me autorizim E.Ç., avokat nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të autorizuarit të paditësve e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.550/2001, i datës 10.07.2013, në seancën jo publike të mbajtur me datë 13.03.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësve A.M., M.M., L.M. dhe M.M.2, të gjithë nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.550/2001, i datës 10.07.2013 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.550/2001, i datës 10.07.2013, me pikën I (një) të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet i padituri Xh.H., nga Prizreni, që paditësve: A.M., të i kompensoj shumën prej 18.000,00 Euro dhe atë 1000,00 Euro në emër të vuajtjeve psikike si pasoj e shpifjes, 2000,00 Euro në emër të dhimbjeve trupore, 2000,00 Euro në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e rënies së aktiviteti jetësor, 2000,00 në emër të fitimit të humbur, 1000,00 Euro në emër të frikës dhe 1000,00 Euro në emër të shpenzimeve të mjekimit, M.M.t, të i kompensojë shumën prej 1000,00 Euro në emër të frikës së intensitetit të lartë, L.M., të i kompensojë shumën prej 1000,00 Euro në emër të frikës së intensitetit të lartë, M.M., të i kompensojë shumën prej 1000,00 Euro në emër të frikës së intensitetit të lartë” si kërkesë e pabazuar.

Në emër të dëmit material shuma e përgjithshme 3935,00 Euro dhe atë: 1575,00 Euro për nëntë dyer të reja, 252,00 Euro për tri dyer të montuara, 350,00 Euro për dëmtimin e derës së hyrjes, 500,00 Euro për dëmtimin e derës metalike, 200,00 Euro për dëmtimin e derës së banjës, 350,00 Euro për dëmtimin e dhjetë “llusterave”, 350,00 Euro për dëmtimin e dhjetë kutive për oxhak dhe 400,00 Euro për dëmtimin e një dollapi.”

Me pikën II (dy) të dispozitivit është detyruar pala paditëse që të i kompensojë shpenzimet procedurale për palën e padituri në shumën prej 240,00 Euro në afat prej 15 ditësh që nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi i autorizuari i paditësve ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Ankesa e të autorizuarit të paditësit i është dorëzuar të autorizuarit të t'paditurit për i njëjti nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 201, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të autorizuarit të paditësve është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit përmes të autorizuarit të tyre me datë 24.09.2001, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri që paditësve tu kompensohet dëmi material dhe jo material me përmbajtje sa i përkiste kategorikeve të dëmit dhe vlerës së kërkuar si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar. Kanë arsyetuar së kërkesa për kompensimin e dëmit mbështet në faktin se i padituri ka shpifur në raport me paditësit dhe për pasoj ka ndodhur bastisja e policisë së UNMIK-ut në shtëpinë e paditësve në atë mënyrë që gjatë bastisjes për shkak të sjelljeve brutale të policisë ka ardhur deri të dëmi material dhe jo material.

Dëmi material i referohet dëmtimeve që kanë shkaktuar policia gjatë bastisjes me thyerjen e dyerve dhe pajisjeve tjera shtëpiake ndërsa dëmi jo material i referohet kompensimit për frikë, vuajtjes psikike për shkak të frikës dhe dhimbjeve fizike. Dëmi është krijuar për arsyeje se gjatë bastisjes paditësit i kanë përjetuar frikë dhe forma tjera të dëmit për të cilat arsye janë vizituar tek mjeku pas bastisjes. Kanë theksuar se kërkesa ka mbështetje duke qenë se i padituri me vendim të gjykatës penale është shpallur përgjegjës dhe është dënuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas paditës së paditësve në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka nxjerr aktgjykimin e atakuar me të cilën e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar dhe i ka detyruar paditësit që të paditurit të ja paguajnë shpenzimet e procedurës.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata ka arsyetuar se deri te përfundimi se kërkesëpadia duhet të refuzohet si e pabazuar ka ardhur për shkak se për ta pranuar kërkesën për kompensim ndër të tjera duhet të ekzistoj subjektet e marrëdhënies detyrimore, gjegjësisht dëmtuesi dhe i dëmtuari si dhe të ekzistoj lidhja kauzale në mes të faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar.

Lidhur me kushtin e parë që të ekzistojë përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet medoemos të ekzistojë subjekti përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Në këtë rast subjekti përgjegjës i cili paditësve ju ka shkaktuar dëmin e mundshëm është policia e UNMIK-ut, fakt i pohuar edhe nga vetë pala paditëse.

Gjykata ka vërtetuar dhe pranuar se i padituri është shpallur fajtor për veprën penale të shpifjes, por i njëjti nuk ka marrë pjesë në shkaktimin e dëmit të paditësve dhe as që ka urdhëruar që ai dëm të shkaktohet.

Në kuptim të nenit 158 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve –(LMD), që të ekzistoj fajësia duhet që dëmtuesi të ketë shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia. Në këtë rast kallëzimi penal që ka bërë i padituri ka ardhur si pasojë e mosmarrëveshjes që ka pasur me paditësit, por që sipas nenit 158 të LMD-së për ekzistimin e përgjegjësisë duhet patjetër të ekzistoj veprimi i dëmshëm, dëmi dhe lidhja kauzale, si kushte të përgjithshme për përgjegjësin për dëmin e shkaktuar si dhe faji si kusht i veçantë. Lidhja kauzale si kusht i përgjithshëm paraqet asi raporti ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, ku veprimi i dëmshëm paraqitet si pasojë e atij veprimi. Në rastin konkret kjo lidhje kauzale nuk ekziston.

Përveç kësaj gjykata ka vlerësuar se gjatë procedurës së të provuarit nuk është provuar se pasojë e shpifjes është dobësuar reputacioni i paditësit e rrjedhimisht nuk është provuar se ka pasur cemin të integriteti moral nga do të rrjedhtë detyrimi për shpërblimin e dëmit. Në kuptim të cekur gjykata ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësve lidhur me kundërthëniet e dispozitivit të aktgjykimit, me arsyetimin e aktgjykimit e po ashtu nuk qëndrojnë as pretendimet se dispozitivi është kundërthënës dhe i pakuptueshëm.

Gjykata e Apelit vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit është i rregullt dhe në përputhje të plotë me kërkesat e LPK-së nga neni 160, paragrafi 3, sepse gjykata ka vendosur për të gjitha kërkesat e parashtruara dhe brenda kufijve të kërkesave, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për përfundimin e gjykatës lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë.

Arsyetimi i aktgjykimit është në rrjedhë logjike për përputhje me kërkesat e LPK-së për përmbajtjen e arsyetimit duke krijuar kështu një koherencë të plotë brenda arsyetimit dhe përputhje me dispozitivin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të çështjes, mënyrën se si i ka vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka kualifikuar faktet në raport me normat materiale-juridike.

Lidhur me pretendimet për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e tilla nuk janë të themelta për faktin se gjykata në mënyrë të plotë ka konstatuar mungesën e lidhjes kauzale në mes të veprimit të t'paditurit dhe dëmit të shkaktuar respektivisht pasojës së shkaktuar tek paditësit, ndërsa për disa kategori të dëmit që mund të kompensoheshin për shkak të përgjegjësisë nga shpifja, gjykata ka konstatuar mungesën e dëmit.

Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi qëndrimin dhe përfundimin e gjykatës së shkallës së parë sepse nga provat e administruara dhe faktet e provuara nuk konsumohen elementet e përgjegjësisë për ta kompensuar dëmin sipas dispozitës së LMD-së nga neni 158.

Dispozita e nenit 14 e LPK-së, e lidh gjykatën në procedurën kontestimore me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor sa i përket ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale, mirëpo fakti se i padituri është shpallur përgjegjës me vendim penal për shpifje nuk ka krijuar bazën e përgjegjësisë që i njëjti të u kompensoj paditësve dëmin sipas kategorive të dëmit që ata kanë parashutuar. Ashtu si që ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë dëmet e mundshme në emër të dhimbjeve trupore, në emër të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e rënies së aktiviteti jetësor, në emër të frikës, në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe dëmi material për dyert e dëmtuara, “për dhjetë llustera”, për dhjetë kuti për oxhak dhe për dëmtimin e një dollapi, nuk përbëjnë kategori të dëmit të cilët i janë shkaktuar nga shpifja por i referohen dëmeve të mundshme të shkaktuara nga veprimet e policisë. Kontrolli respektivisht bastisja janë autorizime të organeve përkatëse të cilat merren sipas autorizimeve që kanë organet e rendit dhe nëse gjatë ushtrimit të këtyre autorizimeve shkaktohet ndonjë dëm atëherë për atë autorizimet janë ushtruar në kundërshtim me ligjin, përgjegjësia për kompensim do të u takoj këtyre organeve.

Gjykata e Apelit e ka pranuar edhe vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se nga vepra penale e shpifjes do të mund të konsiderohej kërkesa për kompensimin e dëmit për shkak të rënies së reputacionit dhe rrjedhimisht kërkesa për fitim të humbur pasojë e rënies së reputacionit, por të dy këto kategori të dëmit përveç se duhet të provohet që ekzistojnë duhet të provohet vlera e dëmit, çka në rastin konkret paditësit nuk kanë arritur ta argumentojnë se kanë pësuar ndonjë dëm që lidhet me rënien e reputacionit apo dhe dëm për kërkesat tjera që lidhen me shpifjen. Vetë vendimi i gjykatës penale për shpifjen ka konsumuar përgjegjësinë e të paditurit për veprimet e tij të lajmërimit respektivisht të denoncimit të paditësit tek policia.

Gjykata e Apelit e pranon detyrimin që ka gjykata civile që vendimi i saj të jetë i lidhur me vendimin e gjykatës penale sipas nenit 14 të LPK-së dhe atë sa i përket ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të kryerësit, por vlerëson se koncepti i nocionit të shpifjes i referohet publikimit të një fakti të pa vërtetë të cilën publikuesi e din apo është dashur ta dije se fakti dhe deklaratatë është e pa vërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e personit tjetër. Pra shpifja në kuptimin e dëmit që mund të shkaktoj si pasojë i referohet ekskluzivisht dëmit që mund që i shkaktohet personit të caktuar për shkak të rënies së reputacionit. Pavarësisht se është konfirmuar vepra penale e shpifjes nuk është provuar rënia e reputacionit si bazë për ta pranuar kompensimin.

Nga të cekurat, Gjykata e Apelit vlerëson se edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë prandaj përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është në tërësi i drejtë dhe i ligjshëm.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e LPK-së për kompensimin e shpenzimeve, ndërsa lartësia e shpenzimeve është në përputhje me veprimet dhe tarifatat që përcaktojnë vlerën e shpenzimeve të përfaqësimit dhe shpenzimeve të gjykatës për taksa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.3839/13, me datë 13.03.2017

Kryetari i kolegjit
Albert Zogaj, d.v